

KONTRATE PER TRANSFERIM TE KUOTAVE

Sot, me date 30/06/2015 ne Tirane, palet e meposhtme:

Shoqeria "**Shijaku**" sh.p.k., person juridik shqiptar, themeluar ne perputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar me Vendim Nr. 10874 date 22/05/1995 te Gjykates se Rrethit Tirane, mbajtes te numer unik identifikimi NUIS J64102272V me seli ne adresen Arrameras, FusheKruje përfaqësuar, në bazë të vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë dt. 30/06/2015 nga administratori **Z. Shpetim Shijaku**, i biri i Sulejmanit, lindur me 01.05.1962 ne Kruje, mbajtes i leternjoftimit Nr.024433891, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar;

Xheladin Zela, i biri i Hamitit , lindur ne 25.05.1968, mbajtes i leternjoftimit me Nr. 028512369, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, banues në adresën Njesia Bashkiake Nr.3, Rr. Violeta Manushi, Vila Nr.84, Tirane, Shqiperi.

*me poshte referuar si "**Shitësi**"*

Z. Rakip Koka, i biri i Mehmetit lindur me 19/04/1974 ne Gjon, Mat, mbajtes i leternjoftimit Nr 024906317, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar, me adresë ne Sukth Durrës.

. **Rakip Koka**, lindur me 19/04/1974 ne Gjon, Mat, mbajtes i leternjoftimit Nr 024906317, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar, sipas këtij rendi të ditës, si më poshtë vijon:

*me poshte referuar si "**Blerësi**"*

Meqenese shitësi-shoqeria "**Shijaku**" sh.p.k. është ortak që zotëron 21.50 % të kapitalit të shoqërisë "**KOKA**" shpk, person juridik shqiptar, themeluar ne perputhje me legjislacionin shqiptar, i regjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit date 08.05.2000, mbajtes te numer unik identifikimi NUIS K06626403L me seli ne adresen Diber Bulqize BULQIZE KRASTE, Shqiperi, ne vleren 22.157.900,00 (njëzet e dy milion e njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind) lekë.

Meqenese shitësi-Xheladin Zela, është ortak që zotëron 27.50 % të kapitalit të shoqërisë "**KOKA**" shpk, person juridik shqiptar, themeluar ne perputhje me legjislacionin shqiptar, i regjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit date 08.05.2000, mbajtes te numer unik identifikimi NUIS K06626403L me seli ne adresen Diber Bulqize,BULQIZE KRASTE, Shqiperi, ne vleren 28.341.500,00 (njëzet e tetë milion e treqind e dyzet e nje mijë e pesëqind) lekë.

Meqenese bleresi-Rakip Koka, është ortak që zotëron 51 % të kapitalit të shoqërisë "**KOKA**" shpk, person juridik shqiptar, themeluar ne perputhje me legjislacionin shqiptar, i regjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit date 08.05.2000, mbajtes te numer unik identifikimi NUIS K06626403L me seli ne adresen Diber Bulqize, BULQIZE KRASTE, Shqiperi, ne vleren



52.560.600,00 (pesedhejtëedymilion e pësëqindmije e gjashtëdhejë e gjashtëqind) lekë

Meqenese kapitali i Shoqërisë është 103.060.000,00 (njëqind e tre milion e gjashtë dhjetë mijë) lekë) i barabartë me 3 (tre) pjesë, kuota me vlera më poshtë:

- 1 (një) pjesë, kuota, ortaku Rakip Koka me vlerë 52.560.600,00 (pese dhjetë e dy milion e pesë qind mijë e gjashtëdhjetë e gjashtëqind) lekë, që përfaqëson 51 % të kapitalit të shoqërisë;
- 1 (një) pjesë, kuota, ortaku Xheladin Zela me vlerë 28.341.500,00 (njëzet e tetë milion e tre qind e dyzet e një mijë e pesëqind) lekë, që përfaqëson 27.50 % të kapitalit të shoqërisë;
- 1 (një) pjesë, kuota, ortaku shoqëria "Shijaku" shpk me vlerë 22.157.900,00 (njëzet e dy milion e njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind) lekë, që përfaqëson 21.50 % të kapitalit të shoqërisë;

rane dakort për afatet dhe kushtet e mëposhtme:

NENI 1 OBJEKTI I KONTRATES

1.1 Blerësi bie dakort të blejë dhe Shitesit bien dakort t'i shesin në total Blerësit 49% të kapitalit të zotëruara nga Shitesit në shoqërinë "KOKA" sh.p.k., sipas cmimit kontraktual të përcaktuar në këto kontrate. Pas transferimit nëpërmjet shitjes, struktura e zotërimit të kuotave në kapitalin e shoqërisë "KOKA" shpk do të jetë si më poshtë:

Rakip KOKA 1 kuota që i përgjigjet 100% të kapitalit të shoqërisë

1.2. Kuotat e shoqërisë "KOKA" sh.p.k. do të transferohen, sipas vlerës nominale të regjistruar në QKR.

NENI 2 CMIMI I SHITJES

2.1 Cmimi total i shitjes së 49 % të kapitalit të zotëruar nga Shitesit është 50,499,400.00 (pesëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind) leke, i ndarë si më poshtë: shuma 28.341.500,00 (njëzet e tetë milion e tre qind e dyzet e një mijë e pesëqind) lekë për pjesën që do të transferohet nga Xheladin Zela dhe 22.157.900,00 (njëzet e dy milion e njëqind e pesë dhjetë e shtatë mijë e nëntë qind) lekë për pjesën që do të transferohet nga shoqëria "SHIJAKU" shpk.

2.2 Shitesit pas nënshkrimit të kësaj kontrate nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me kërkimin e pagimit të ndonjë të ardhurë në formën e fitimit që shoqëria "KOKA" sh.p.k. ka realizuar gjatë periudhës që kanë qënë ortakë në këtë shoqëri.



**NENI 3
AFATET E PAGESES**

3.1 Cmimi i shitjes eshte paguar nga Bleresi, jashte zyres se Noterit dhe Shitesi deklaron se nuk ka dhe nuk do te kete asnje kundershtrim apo pretendim si tani ashtu dhe ne te ardhmen lidhur me kete pageese.

**NENI 4
KUSHTET E MBYLLJES**

4.3 Pavec atyre te parashikuara ne kete kontrate, qe kontrata te konsiderohet e rregullt dhe te prodhoje efektet e saj duhen plotesuar kushtet e meposhtme te kontrates:

- Qe Shitesit zoterojne 27.50% per Xheladin Zela dhe 21.50% per shoqerine "Shijaku" te kuotave te Shoqerise;
- Qe kuotat jane krejtesisht te paguara;
- Qe nuk ekziston asnje marreveshje ose alternative, pas te ciles Shitesi eshte ose mund te jete i detyruar te shes kuotat nje pale te trete;
- Qe kuotat shiten te lira cdo barre apo peng;
- Me transferimin e ketyre kuotave, Bleresi perfiton te gjitha te drejtat dhe detyrimet ne lidhje me keto kuota, perfshire edhe marredheniet me palen e trete;
- Qe cdo miratim i kerkuar per transferimin e kuotave eshte dhene, ne perputhje me legjislacionin perkates;

**NENI 5
DATA E MBYLLJES**

5.1 Kontrata e transferimit te kuotave do te konsiderohet e mbyllur ne momentin kur Bleresi te pajiset me certifikaten perkatese nga Qendra Kombetare e Rregjistrimit.

**NENI 6
LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURISDIKSIONI**

6.1. Cdo mosmarreveshje apo kundershtrim qe lind ne lidhje me interpretimin apo ekzekutimin e kushteve te kontrates, te cilat nuk mund te zgjidhen miqesisht midis paleve, do te zgjidhen ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane. Ligji i zbatueshem do te jete legjislacioni Shqiptar.

**NENI 7
TATIMI**

7.1 Ne perputhje me legjislacionin tatimor shqiptar ne fuqi, ky transaksion nuk eshte objekt tatimi mbi te ardhurat meqenese cmimi kontraktual i percaktuar nga palet per transferimin e kuotave nuk krijon ndonje te ardhur apo fitim per Shitesin.



NENI 8
DISPOZITA TE NDRYSHME

- 8.1. Pavlefshmeria per cdo arsye e nje dispozite apo pjese dispozitash, do te vecohet dhe nuk do te ndikoj ne vlefshmerine e dispozitave te tjera te kesaj kontrate.
- 8.2. Kjo kontrate do te depozitohet ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit ne Shqiperi.
- 8.3. Kjo kontrate eshte hartuar ne 6 (gjashte) kopje origjinale ne gjuhen shqipe dhe angleze, qe kane vlere te barabarte ligjore. Ne rast mosperputhjeje midis tekstit ne Shqip dhe Anglisht, versioni Anglisht do kete perparesi.

SHITESI

Shoqëria "Shijaku" sh.p.k.
Shpetim Shijaku
Shpetim Shijaku



Xheladin ZELA

Xheladin Zela
[Signature]

BLERESI

Rakip Koka

Rakip Koka
[Signature]

